


Tiranë, 16 Korrik 2009

Projekti i monitorimit të medias mbi anëshmërinë politike u zhvillua përgjatë gjashtë javëve duke filluar nga 15 Maj deri më 28 Qershor 2009. Ky projekt u mundësua nga USAID dhe u realizua nga një ekip monitoruesish të organizuar nga DeltaMCM, një agjenci e pavarur shqiptare e specializuar në sektorin e monitorimeve mediatike.

Ai u fokusua ne gjashtë televizione (News 24, Top Channel, TV Klan, TV Koha, TVSH dhe Vizion Plus) dhe katër gazeta (Gazeta Shqiptare, Panorama, Shekulli dhe Shqip) të përzgjedhur sipas rëndësisë së tyre në bazë të të dhënave nga kompani të specializuara të matjes së audiencës dhe tirazheve të mediave elektronike dhe të shkruara. Ky monitorim u bazua në vlerësimin sasior dhe cilësor të mbulimit mediatik për partitë politike dhe politikanët.

Një përshkrim më i hollësishëm i metodologjisë për vlerësimin sasior dhe cilësor të mbulimit mediatik që u përdorën gjatë këtij monitorimi gjendet në faqen zyrtare të DeltaMCM <http://www.mcmonitoring.org/reports.html>.

Disa nga gjetjet kryesore për mediat televizive përfshijnë:




Partia Demokratike ishte subjekti që u mbulua më gjerësisht nga gjashtë kanalet televizive gjatë gjashtë javëve të monitorimit. Ajo pati rreth 6400 minuta mbulim nga të cilat vetëm rreth 300 minuta ishin mbulim me qëndrim negativ. Partia Socialiste e ndoqi atë nga afër duke patur rreth 5900 minuta mbulim nga të cilat 100 ishin mbulim negativ.

Qeveria ishte subjekti i tretë që pati mbulimin më të madh nga të gjitha televizionet e monitoruara, me rreth 3000 minuta në dispozicion, nga të cilat rreth 400 ishin me ngjyrim negativ. LSI ishte subjekti që pasonte në listën e minutazhit, duke patur rreth 1000 minuta mbulim ndër të cilat 50 me qëndrim negativ.

Referuar mbulimit pozitiv, neutral apo negativ, të gjashtë kanalet televizive që u monitoruan u treguan në shumicën e rasteve neutrale dhe të balancuara kundrejt pjesës më të madhe të partive politike.

Disa nga gjetjet kryesore për shtypin e shkruar përfshijnë:



Gazeta Shqiptare, Shekulli dhe Shqip patën Partinë Socialiste si subjektin politik me mbulimin më të madh. Partia Demokratike ishte e dyta në mbulim nga këto gazeta, por më shumë se 30% e hapësirës që iu dha asaj ishte e natyrës negative. Panorama i dha hapësirën kryesore Partisë Demokratike duke mbajtur njëkohësisht qëndrim neutral ose pozitiv ndonëse rreth 18% e hapësirës për këtë parti përfshinte qëndrim kritik ose negativ në kontekst apo në ton. Për Gazetën Shqiptare, Panoramën dhe Shqip, LSI ishte partia e tretë me mbulimin më të madh, ndërkohë Shekulli ia dha këtë pozicion Partisë Demokratiane.

Ndërkohë që kanalet televizive ishin neutrale ose nganjëherë edhe pozitive në mbulimin e tyre të partive duke pasur shumë pak raste mbulimi negativ, gazetatat ofruan më shpesh mbulim që ndahej ose në pozitiv ose në negativ.

Nga të gjitha gazetatat e monitoruara, Panorama ishte më e balancuara si në përmbajtje ashtu edhe në hapësirë.

Një raport i hollësishëm ku përfshihen të dhënat për të gjitha televizionet dhe gazetatat mund të aksesohet në faqen zyrtare <http://www.mcmonitoring.org/reports.html>.

Per me shume informacion mund te kontatoni:

Sokol Shameti

DeltaMCM

Tel: 0692033001

Email: info@mcmonitoring.org